



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:147936

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05652682

P.nr.../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit S... Xh.... për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.1328/22 të datës 20.07.2022, jashtë seancës gjyqësore me datë 03.05.2024 bie këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr.../.. e datës, lidhur në mes të pandehurit S... Xh.... dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K... sh.a në P....

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr. 1328/22 të datës 20.07.2022.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit S... Xh...., i lindur më në fshatin N..... Komuna P..., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., i nacionalitet shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

- për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën ka ngritur aktakuzën PP/II nr.1328/22 ndaj të pandehurit S... Xh.... për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Me datën është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurit pandehurit S... Xh.... dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K... sh.a në P..., me nr, Nd.nr.../.. e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si ne pikën I të dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr.../... e datës, lidhur në mes të pandehurit dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K... sh.a në P....

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërprejë procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,
DIVIZIONI PENAL
2022:147936, 03.05.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

Gj y q t a r i

Edona Berisha Kastrati

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi